

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kongresistë republikanë kërkojnë të mos i zgjatet licenca Industrisë së Naftës së Serbisë
ADRESA	https://dosja.al/bota/kongresiste-republikane-kerkojne-te-mos-i-zgjatet-licenca-industri-se-se-naf-i516556
BURIMI	dosja.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 16:01:11 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 15:55:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	11577d68dc31d598285d603df816d5a384c4fbcf8f2e490cd584728d8c9d8c11
TEKSTI	a25414c38af1e90a86715bd13f2542c5adeed6adf2e909d0194d8dfcb31454ca
PAMJA	01bdcfd9489974bb5c7fe541e884bceca2653313519741299483b60c928a1948

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	31285b1070f2451e2cb7cd6e2121d62cda8957d4d0e3503372984305bc79eafa
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	2a9c3c61cd0a94fc8d628189ad3d77be9fe8dbec0733dde85be2277fcecbb101e
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/31285b1070f2451e2cb7cd6e2121d62cda8957d4d0e3503372984305bc79eafa>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



LIVE UPDATES

3 ORE ME PARE

Pagat e magistratëve/ GJL dhe shoqatat e gjyqtarëve nuk marrin pjesë në tryezën e Ramës. Kryeministria: Do vazhdojmë punën për ligjin e pagave

6 ORE ME PARE

Konferenca Ndërparlamentare/ Schieder tregon detyrat: Kapitujt duhen mbyllur. Rama: Europa mos të na lërë në baltë, do jetë dështim

7 ORE ME PARE

Përfundon mbledhja e Këshillit të Sigurisë Kombëtare, në fokus hetimi ndaj ish-drejtoreshës së SHISH dhe siguria e informacionit të klasifikuar

22 ORE ME PARE

120 ditë protestë/ Qytetarët zbresin sërish në shesh, me thirrje e pankarta në duar: Rama jep dorëheqjen

Bota

Kongresistë republikanë kërkojnë të mos i zgjatet licenca Industrisë së Naftës së Serbisë

NIS-i është nën sanksione amerikane për shkak se shumica e pronësisë së saj është në duart e kompanive ruse. Pronarët rusë gëzojnë 56.15 për qind të aksioneve, prej të cilave 44.85 për qind i përkasin kompanisë shtetërore Gazprom Neft.



28 Shtator 2026, 17:55
Nga G.M



Kongresisti republikan, Joe Wilson. Fotografi nga arkivi.

editoriale

Meri Lika

Opinion kundër mbi një konferencë pa pyetje

Enton Abilekaj

Labirinti i errët i Edi Ramës

Në vëmendje

Dy republikanë në Dhomën e Përfaqësuesve të Shteteve të Bashkuara i kanë bërë thirrje administratës së presidentit Donald Trump që t'i vazhdojë sanksionet ndaj Industrisë së Naftës së Serbisë (NIS), raportoi të hënën mediumi amerikan The Hill.

NIS-i është nën sanksione amerikane për shkak se shumica e pronësisë së saj është në duart e kompanive ruse. Pronarët rusë gëzojnë 56.15 për qind të aksioneve, prej të cilave 44.85 për qind i përkasin kompanisë shtetërore Gazprom Neft.

Kongresistët republikanë Joe Wilson dhe Keith Self i dërguan të premtën letër Departamentit amerikan të Thesarit, në të cilën kundërshtuan zgjatjen e lehtësimit nga sanksionet për NIS-in.

"Po ju shkruajmë për t'ju kërkuar me respekt që ta rishikoni zgjatjen e të gjitha licencave shtesë të përkohshme që do t'i mundësonin Industrisë së Naftës së Serbisë të vazhdojë punën, pavarësisht sanksioneve amerikane që lidhen me pronësinë e saj ruse", thuhet në letër.

Letra i është drejtuar sekretarit amerikan të Thesarit, Scott Bessent. NIS-i i kërkoi javën e kaluar Departamentit amerikan të Thesarit t'ia lëshojë një licencë të re, e cila do t'i mundësonte vazhdimin e punës.

Licenca e tanishme për NIS-in, e lëshuar nga Zyra për Kontrollin e Pasurive të Huaja (OFAC) në kuadër të Departamentit amerikan të Thesarit, skadon më 30 shtator. Administrata amerikane vendosi sanksione ndaj NIS-it në fillim të vitit 2025, me qëllim për t'ia pamundësuar Rusisë përdorimin e të ardhurave nga sektori energjetik për luftën në Ukrainë.

AKTUALITET 28 SHTATOR 2026, 16:51

Reforma territoriale/ Këshilli Bashkiak i Belshit voton kundër bashkimit me Elbasanin

POLITIKE 28 SHTATOR 2026, 13:36

VIDEO/ Ambrozia Meta pyet Ramën për Ergys Agasin, kryeministri largohet me shpejtësi pas gardës

Për më shumë se një vit, sanksionet janë shtyrë, ndërsa qëkurse kompania hungareze MOL u shfaq si blerëse e interesuar, licenca e OFAC-it për veprimtarinë e NIS-it është rinovuar periodikisht. NIS-i furnizon 80 për qind të nevojave energjetike të Serbisë, por është në pronësi shumicë të gjigantëve energjetikë rusë Gazprom Neft dhe Gazprom, të cilët janë nën sanksionet e SHBA-së.

Wilson dhe Self shprehin shqetësim se përjashtimet po i mundësojnë NIS-it që t'i zvarrisë negociatat për shitjen e aksioneve ruse në kompani. Në janar, kompania hungareze MOL njoftoi se kishte arritur marrëveshje me Gazprom Neft për blerjen e aksioneve të tij në shumicë në NIS, por marrëveshja ende nuk është përmbyllur.

"Negociatat për marrëveshjen përfundimtare të blerjes janë ende duke vazhduar, ndërsa MOL-i i ka kërkuar departamentit tuaj miratim të mëtejshëm për vazhdimin e operimit, pavarësisht përparimit të kufizuar", thanë kongresistët.

"Për më tepër, Serbia vazhdon të mbajë lidhje të ngushta politike dhe ekonomike me Rusinë dhe, ndryshe nga shumica e vendeve evropiane, nuk ka vendosur sanksione ndaj Moskës pas pushtimit të Ukrainës në shkurt të vitit 2022", shtuan ata.

Për shkak të lidhjeve mes Serbisë dhe Rusisë, shqetësime janë shprehur edhe në Kongresin amerikan. Gjatë një debati në mesin e shtatorit në Kongres, u shpreh shqetësim dypartiak për marrëdhëniet e Serbisë me Rusinë dhe Kinën, ndërsa u ngritën edhe pyetje nëse, në kuadër të Dialogut Strategjik SHBA-Serbi, është diskutuar për "ndikimin keqdashës" të Moskës dhe Pekinit./REL

serbi rel

Sondazh

Poll

Bota

28 Shtator 2026, 17:20

Kërkoj masa kundër Ebolës, politikani në Kongo rrihet për vdekje dhe i digjet shtëpia

Marie-Célestine Carontois RD KONGO- Një zyrtar i lartë i partisë në pushtet në Republikën Demokratike të Kongos &...

Komediani turk dënohet me 19 muaj burg për fyerje ndaj Erdoganit, përdori termin 'diktator' në një shfaqje humoristike

Bota

28 Shtator 2026, 17:03

AKTUALITET 28 SHTATOR 2026, 13:01

FOTOLAJM/ Kush janë dy të rinjtë që tentuan të mashtronin Armand Dukën dhe lidhja me Florian Gjergjin

më të klikuarat

Labirinti i errët i Edi Ramës

Hakerat iraniane nxjerrin mbi 600 numra të personelit të SHISH-it, publikojnë edhe dokumente konfidenciale

VIDEO/ Ambrozia Meta pyet Ramën për Ergys Agasin, kryeministri largohet me shpejtësi pas gardës

WSJ zbardh prapaskenat: Ja si e ndihmoi ambasadorja amerikane kompaninë greke të siguronte marrëveshjen 6 mld \$ në Shqipëri

insights

Bledian Koka

Pse Rama i denoncoi shqiptarët si antisemitë në OKB

Besmir Semanaj

Kur të bie Diella në kokë

Rezarta Gagani

Përballë pallatit tim po ndërtohet një pallat

Auron Janku

Kur PARTITË harrojnë pse ekzistojnë

Moti

Powered by tomorrow.

**"Mund të rrëzojmë çdo qeveri që duam"/
Deklarata e ambasadores amerikane
shkakton polemika në Athinë, opozita
kërkon shpjegime**

Bota

28 Shtator 2020, 16:17

**Ukraina raporton bombardime
vdekjeprurëse ruse në Kiev, Harkiv dhe
Dnjepër**

Bota

28 Shtator 2020, 16:12

**Përfshihet nga flakët Akademia e
Shkencave në Kiev pas sulmeve ruse,
raportohet një viktimë dhe disa të
plagosur (VIDEO)**

Bota

28 Shtator 2020, 15:51

Bota

28 Shtator 2020, 15:43

**BE miraton pesë programe të mbrojtëse me një
buxhet prej 325 mln eurosh, mbrojtja ajrore në
qendër të vëmendjes**

Forcat e NATO-s EVROPA- Bashkimi Evropian po bën një hap drejt
forcimit të autonomisë së tij mbrojtëse, pasi miraton pesë...

**Brukseli ia kujton Serbisë nevojën për
zbatimin e sanksioneve të BE-së ndaj
Rusisë pas bisedës Vuçiç-Putin**

Bota

28 Shtator 2020, 15:10

**SHBA dhe Kina ulin tarifatat për 60
miliardë dollarë mallra, një hap drejt
zbutjes së tensioneve tregtare mes dy
ekonomive botërore**

Bota

VIDEO/ Spektakël mbresëlënës nga shpërthimi i vullkanit Kilauea, lava ndriçon qiellin e natës

Bota


28 Shtator 2026, 14:16

Pesë britanikë arrestohen pranë bazës ajrore RAF Fairford, dyshohen për përgatitje të një akti terrorist

Bota

28 Shtator 2026, 14:04

MË SHUMË



Protesta në Maliq kundër investimit të Ujësllësit/ Përplasje mes efektivëve dhe qytetarëve

Shiko video te tjera




KTHEHU NE KRYE



Dosja.al është një iniciativë gazetare e rinj dhe njerëzish të lirë, që nuk ndikohet nga interesa politike apo biznesi. Informimi i paanshëm, qëndrimi i pavarur dhe etika profesionale janë parimet tona. Ka media të majta, të djathta, ka media në shërbim të partive apo biznesit, por ka edhe të pavarura, që kanë zgjedhur rrugën më të vërtetë, por më të ndershme dhe më të sigurtë për të qenë të besueshëm. Dosja.al do të jetë gjithmonë e pavarur, e vërtetë, në krah të interesit publik.

Telefon/Whatsapp: +355 68 2676 444
Email:



KONTAKT PRIVACY POLICY COOKIES

MEMBERSHIP NGA Mediaset

AKTUALITET

POLITIKE

EKONOMI

BOTA

SPORT

ART&ARGËTIM

INSIGHTS

EDITORIAL

Drejtore: Anton Abilekaj

Kryeredaktor: Izmir Akulli

Gazetarë:

Esmeralda Doçi

Emanuela Dida

Elisa Karaj

Dorotea Simoni